



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
01Nr. _____/09
Kaçanik _____ 2009

KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK
SHËRBIMI PËR PUNË PROFESIONALE TË KUVENDIT

BULETINI
PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
17.11.2007-15.11.2009

Nëntor , 2009

H Y R J E

Ky Buletin përfshinë Aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut , prej zgjedhjeve të datës 17.11.2007- 15.11.2009.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e Përpiluara gjat punës së Kuvendit.

Buletini është përluar nga Shërbimi për Punë Professionale të Kuvendit të Komunës.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të kuvendit të komunës për gjat kësaj periudhe, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit është mirënjohës për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që do të ipen lidhur më te. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhëshme të jetë sa më i suksesëshëm dhe cilësor.

ECURIA E ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet e Kosovës u mbajtën më 17 Nentor 2007.

Në këto zgjedhje është votuar për Kuvendin e Kosovës, Kuvendet Komunale dhe për Kryetar të Komunave.

Në komunën e Kaçanikut në këto zgjedhje, konkuruan 8 parti politike dhe një kandidat i pavarur.

Në zgjedhje morën pjesë: 16.552 votues.

Konkuruesit në garat zgjedhore, për kuvendin e komunës, arritën këto rezultate;

Për PDK-Partia Demokratike e Kosoves,	votuan 8.537 apo 51.58%	dhe fitoi 17 vende.
Për LDK-Lidhja Demokratike të Kosoves,	2.829 apo 17.09%	“ 5 vende
Për AKR- Aleanca Kosova e Re ,	1.706 apo 10.31%	“ 3 vende
Për AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosoves,	1.657 apo 10.01%	“ 3 “,
Për LDD –Lidhja Demokratike e Dardanisë ,	1.038 apo 6.27%	“ 2 “,
Për ORA-Partia Reformiste Ora,	535 apo 3.23%	“ 1 “,
Për PD-Partia e Drejtësisë	151 apo 0.91%	“ 0 “,
Për Ballin Kombëtar ,	51 apo 0.31%	“ 0 “
Për Kandidati e pavarur –Fadil Mustafa,	48 apo 0.29%	“ 0 “.

Për kryetar të komunës së Kaçanikut, konkuruan:

1. Nga PDK-a , Xhabir Zharku, dhe mori numrin e votave:	41.9%,
2. Nga LDK-a, Hebib Shehu “ “ “ “	17.7%,
3. Nga AAK-a, Deli Krivanjeva “ “ “ “	9.8% ,
4. Nga AKR-a, Naser Troni “ “ “ “	10.4% ,
5. Nga LDD-a, Shiqeri Luzha “ “ “ “	6.3% dhe
6. Kandidati i Pavarur , Tahir Çaka ,” “ “ “	13.9%.

Meqenëse asnjë nga kandidatët që konkuruan për kryetar komune nuk kanë fituar shumicën e votave, atëherë dy kandidatët me numër më të madh të votave;

1. Xhabir Zharku nga PDK -a dhe
 2. Hebib Shehu nga LDK-a
- kanë shkuar në “Balotazh”, në Rundin e dytë të votimit.

Zgjedhjet për kryetar të komunave që kanë shkuar në balotazh, janë mbajtur më datë 8 dhjetor 2007.

Për Kandidatin nga PDK-a , Xhabir Zharku kanë votuar: 9,663 veta apo 75.3%, ndërsa
Për Kandidatin nga LDK-a, Hebib Shehu kanë votuar: 3,172 veta apo 24.7%

Për kryetar komune më numër më të madh të votave u zgjodhë, XHABIR ZHARKU nga subjekti i PDK-a.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2007/30 e shpallur me 16 tetor 2007 për ndryshimin e Rregullorës 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, organi më i lartë i komunës është: Kuvendi i Komunës, ndërsa organi më i lartë ekzekutiv është Kryetari i Komunës, organe këto të cilat zgjidhen në formë direkte (më votën e popullit).

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalur më zgjedhjet e mbajtura më 17.11.2007, numëron 31 anëtar.

Përbërja e kuvendit të komunës pasqyron përfshirjen e spektrit politik që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe kanë fituar numër të mjaftueshëm të votave.

Kuvendi i Komunës Kaçanik ka këtë përbërje të spektrit politik

PDK-Partia Demokratike e Kosovës-Dega në Kaçanik:

- | | | |
|----------------------|----------------------|---------------------|
| 1.Xhelal Gashi, | 7.Ibush Vishi, | 13.Danush Koxha, |
| 2.Heset Loku, | 8.Misim Sopa, | 14.Zekirja Loku, |
| 3.Bahrie Çaka, | 9.Lumnije Troni, | 15.Nadire Mici, |
| 4.Habib Guri (SHGP) | 10.Afrim Bajrami, | 16.Muharrem Ahmetaj |
| 5.Rushan Ceka, | 11.Sylejman Neziraj, | dhe |
| 6.Fevzije Berisha, | 12.Sevdije Thaqi, | 17. Diana Bajrami. |

LDK-Lidhja Demokratike e Kosovës-Dega në Kaçanik:

- | | |
|---|--------------------|
| 1.Daut Rudi,(shef i grupit parlamentar) | 4.Ahmet Kalisi dhe |
| 2.Fevzi Dogani, | 5. Lejla Koxha. |
| 3.Hyrjete Isufi, | |

AKR-Aleanca Kosova e Re-Dega në Kaçanik

- | | |
|--------------------------|--------------------|
| 1.Naser Troni, | 3. Samira Burniku. |
| 2.Afrim Loku (SHGP) dhe | |

AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Dega në Kaçanik

- | | |
|-----------------------|-------------------|
| 1.Shukri Luta, (SHGP) | 3.Sevdije Frangu. |
| 2.Miqail Vila dhe | |

LDD- Lidhja Demokratike e Dardanisë-Dega në Kaçanik

1. Shiqeri Luzha (SHGP) dhe
2. Zajrete Muhaxheri.

Partia Reformiste ORA- Dega në Kaçanik,

- 1.Rami Çaka.

30 anëtarë të Kuvendit të Komunës Kaçanik e bënë Betimin Solemn në Mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës të datës 24.12.2007, ndërsa anëtari Afrim Loku, e bëri Betimin më datë 17.01.2008.

Vlenë të përmendet se përbërja e këtyre të Kuvendit të Komunës pëson ndryshime, me atë që anëtari, Misim Sopa jep dorëheqje për arsye se shprehë dëshirën të e mbajë postin: “Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale” emëruar nga kryetari i komunës, dhe në vend të tij për anëtar të kuvendit të komunës caktohet : Hajrush Dullovi.

Edhe anëtari i zgjedhur i kuvendit z. Hestet Loku jep dorëheqje për shkak të emërimit të tij: Shef i Administratës dhe Përsoneelit dhe në vend të tij caktohet: Beqir Krasniqi.

Dorëheqje kanë ofëruar edhe anëtarët: Rushan Ceka , për shkak të emërimit të tij, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Zajrete Muhaxheri, për shkak të emërimit të saj Gjyqjetare në Gjykatën Komunale për Kundravajtje në Prishtinë, dhe në vend të tyre caktohen:Shefqet Lusnjani dhe Elife Murseli.

Gjithashtu për shkak të pozicionit të anëtarit në dy kuvende komunale, Hyrijete Isufi dhe Ahmet Kalisi nga Hani i Elezit kanë ofëruar dorëheqje nga posti i anëtarit të kuvendit komunal Kaçanik, për të mbetur në postin e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit dhe në vend të tyre, caktohen: Teuta Hoxha dhe Kadrush Dogani.

Në bazë të nenit 27.1 lidhur më nenin 13.1 të Rregullorës 2007/30 kryetari i komunës ushtron funksionin e kryesuesit të kuvendit komunal. Kryetari i konvokon dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Kryetari i komunës në konsultim më Kuvendin e Komunës në bazë të nenit 27.2 , i emëron drejtorët e drejtorive komunale. Në pajtim më këtë nen kryetari i komunës më datë: 17.01.2008,;ka emëruar drejtorët e drejtorive komunale-anëtarë të Bordit të Drejtorëve, këta persona:

1. Azem Guri, për Drejtor të Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë,
2. Misim Sopa, për Drejtor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale,
3. Fikri Verbani, për Drejtor të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim,
4. Fatos Koxha, ushtrues detyre i drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
5. Hestet Loku, ushtrues detyre i Shefit të Administratës dhe Përsoneelit,

Në ndërkohë, më Vendime të kryetarit të komunës emërohen edhe këta drejtorë të drejtorive komunale:

1. Rushan Ceka, për Drejtor të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë
2. Bekim Troni për Drejtor të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ,
3. Përparim Hajdari për drejtor të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme dhe
4. Nuhi Provoliu për Drejtor të Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,

Në ndërkohë drejtori i DAP, Përparim Hajdari e lëshon këtë post për shkak të studjimeve master jashtë vendit dhe në vend të tij emërohet: Jeton Topalli.

Me Bordin e Drejtorëve udhëheq kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku.

Me vendim të kryetarit të komunës, është emëruar nënkryetar komune z. Hestet Loku.

STRUKTURA E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

*Kuvendi i Komunës numëron 31 anëtar.

*Struktura gjinore është:

- meshkuj: 22 anëtarë dhe
- femra: 11 anëtar.

*Moshë e anëtarëve të Kuvendit të Komunës është:22-55 vjet.

- * Sipas vendbanimeve, anëtarë të zonës ;
- urbane janë: 18 anëtarë,
 - rurale, janë: 13 anëtarë.

*Sipas kualifikimit, Kuvendi i Komunës ka:

- me kualifikim të mesëm: 4 anëtarë,
- me kualifikim të lartë: 7 anëtarë,
- me kualifikim superior: 17 anëtarë,
- më titull: magjistër: 1 anëtar.
- me titull: doktor shkence, 1 anëtarë
- student: 1 anëtarë.

*Kuvendi i Komunës nga anëtarët e vet i ka të punësuar:25, ndërsa të papunë 6.

*Sipas gjendjes familjare të martuar janë: 25, ndërsa të pamartuar janë:6.

*Anëtarë e Kuvendit të Komunës jetojnë në bashkësi familjare më numër të anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të gjerë, numri i të cilëve sillet prej 2 deri 13 anëtarë të familjes.

*Sipas gjendjes materiale, anëtarët e Kuvendit të Komunës kryesishtë jetojnë nga të ardhurat personale që i realizojnë nga marëdhënja e punës.

Vërejtje: të dhënat lidhur me gjendjen familiare, materiale etj, pësojnë ndryshime ngase të dhënat janë marrë mënjëherë pas konstituimit të kuvendit të komunës.

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS

KONSTITUIMI (INAUGURIMI) I KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja e I-rë

Kryetari i Komunës së Kaçanikut në përbërjen e mëparshme z. Xhelal Gashi, ka ftuar mbledhjen Inaguruese të Kuvendit më anëtarët e rinjë, për datë: 24.12.2007.

Në mbledhjen me karakter Përrues(Inaugurues) do të bëhet betimi i anëtarëve të rinjë të zgjedhur të kuvendit të komunës. Sipas nenit 12.1 të Rregullorës 2007/30 për Ndryshimin e Rregullorës 2000/45 për Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, përfaqësuesi më i vjetër i Kuvendit të Komunës udhëheq më mbledhjen derisa kryetari i ri të jep Betimin Solemn.

Pas fjalës përshendetëse të kryetarit aktual të kuvendit të komunës z.Xhelal Gashi, mbledhjen e udhëhoqi anëtari më i vjetër i kuvendit të komunës z. Sylejman Neziraj.

Në mbledhje prezentuan 30 anëtarë, kurse mungoj 1 anëtar.

Në këtë mbledhje, 30 anëtarë të Kuvendit të Komunës bënë Betimin Solemn dhe nënshkruan Deklaratat Solemne.

Më këtë konstatohet se u bë: **Inaugurimi(Konstituimi) i kuvendit të komunës Kaçanik,**

Pasiqë u bë Inaugurimi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, para **kuvendit të komunës e bëri Betimin dhe e nënshkroj Deklaratën Solemne kryetari i zgjedhur i komunës, z.Xhabir Zharku,** më pas vazhdoj më udhëheqjen e mbledhjes më pikët e mbetura.

-Fjala përshendetëse e kryetarit të ri të zgjedhur,

Fjala përshendetëse e kryetarit z. Xhabir Zharku

Të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar të pranishëm të tjerë,

Kam nderin që të ju përshëndes të gjithëve e në veçanti përshëndes familjarët e dëshmorëve, viktimave civile, invalidët e luftës dhe të gjithë ata të cilët u sakrifikuan që ne të jetojmë sot të lirë.

Me këtë rast, unë shpreh gatishmërinë time dhe përkushtimin e sinqertë në mënyrë që të krijohen kushte për të gjithë qytetarët e kësaj komune dhe garantoj se do të angazhohemi maksimalisht që amanetin e dëshmorëve ta qojmë në vend.

Po ashtu iu garantoj se do të përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut për një jetë sa më të mirë për të gjithë.

-Deklaratat e interesave financiare të delegatëve të kuvendit të komunës dhe e kryetarit të komunës dhe

-Mbyllja e séances.

Viti, 2008

Mbledhja e I-rë (parë) zgjedhore

Mbledhja e parë më karakter zgjedhorë e Kuvendit të Komunës u mbajtë më datë 17.01.2008.

Mbledhjen e kryesoj: z.Xhabir Zharku, kryetar i Komunës.

Në këtë mbledhje, Betimin për anëtar kuvendi e dha Afrim Loku-nga subjekti i AKR, e nënshkroj deklaratën solemne dhe e deklaroj gjendjen e pasurisë.

Vendimet e marrura në këtë mbledhje:

1. Vendimi për zgjedhjen e Xhelal Gashi për zëvendëskryesues të kuvendit të komunës,
2. U njoftua Kuvendi i Komunës me Vendimin e kryetarit të komunës për emërimin e Drejtorëve të Drejtorive Komunale ,
3. Vendimi për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës,

4. Vendimi për formimin e grupit punues për Ndryshim - Plotësimin e Statutit të Komunës, në përbërje:

- 1.Xhabir Zharku, kryetar i komunës,
- 2.Xhelal Gashi, zëvendëskryesues i KK
- 3.Heset Loku, anëtar i KK nga PDK
- 4.Daut Rudi, anëtar i KK nga LDK
- 5.Zajrete Muhaxheri, anëtar i KK nga LDD
- 6.Kefsere Koxha, zyrtare e auditimit të brendshëm
- 7.Zylbehar Shehu, punëtor në gjykatë
- 8.Ester Mjaku dhe shoqëria civile dhe
- 9.Shemsedin Abazi. shoqëria civile.

4. Vendimi për shpalljen e Konkursit për emërimin e drejtorit të drejtorisë për Administratë dhe Përsoneel;

5. Vendimi për Formimin e Panelin Intervistues(Kolegjit)për zhvillimin e procedurës së Intervistimit, për përzgjedhjen e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë dhe Përsoneel, në përbërje;

- 1.Xhabir Zharku, kryesues,
- 2.Xhelal Gashi, (PDK)
- 3.Lejla Koxha, (LDK)
- 4.Elmihane Malsiu , nga shoqëria civile dhe
- 5.Sali Selmani. nga shoqëria civile.

6.Vendimi për Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në përbërje:

1. Xhelal Gashi, për anëtar nga PDK,
2. Muharrem Ahmetaj, “ “ “ “ ,
3. Bahrie Çaka, “ “ “ “ ,
4. Zekrija Loku, “ “ “ “ ,
5. Fevzi Dogani, “ “ “ LDK,
6. Samira Burrniku, “ “ “ AKR dhe
7. Shukri Luta. “ “ “ AAK.

Kryesuesi i KPF-a sipas funksionit është kryetari i komunës, ndërsa pas aprovimit të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, kryesuesi i kuvendit e kryeson edhe Komitetin për Politikë dhe Financa.

7.Vendimi për formimin e Komitetit për Ndërmjetësim, në përbërje:

1. Rami Çaka, për kryesues, nga ORA
2. **Ahmet Kalisi,** “ **anëtar** “ **LDK**
3. Sevdije Thaqi, “ “ “ PDK

- | | | | | |
|----------------|---|---|---|-------------|
| 4. Faik Guri, | “ | “ | “ | komuniteti |
| 5. Sabit Raka. | “ | “ | “ | komuniteti. |

Pas një periudhe , kjo përbërje pëson ndryshime më ate që anëtari Ahmet Kalisi jep dorëheqje , ndërkaq në vend të tij nuk caktohet kush.

8.Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete, në përbërje;

- | | | |
|---------------------|------------------|------------------|
| 1. Shyqeri Luzha, | për kryesues nga | LDD, |
| 2. Afrim Loku, | “ anëtar | “ AKR, |
| 3. Lumnije Troni, | “ “ | “ LDK |
| 4. Bislim Krasniqi, | “ “ | “ komuniteti dhe |
| 5. Shemsedin Abazi. | “ “ | “ KMLDNJ. |

9. Vendimi për Hartimin e Rregullorës për Riorganizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

10.Autorizohet kryetari i komunës për caktimin e një ushtruesi detyre të drejtorit në drejtorinë për administratë dhe personel.

11.Misim Sopa, paraqet Dorëheqje nga anëtari i Kuvendit të Komunës si pasojë e mospërputhshmërisë së funksionit.

MBLEDHJA e II-të(Dytë)

Mbledhja e dytë është mbajtur më datë:28.02.2008, kryesuar dhe udhëhequr nga z.Xhabir Zharku, kryetar komune dhe z.Xhelal Gashi, Zëvendëskryesues i kuvendit të komunës.

Në këtë mbledhje kuvendi i komunës;

1. Aprovon Planin e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2008,
2. Aprovon Raportin për Realizimin e Mjeteve Bugjetore, për vitin 2007,
3. Merr Vendim për emërimin e Hestet Loku, Shef i Departamentit të Administratës dhe Përsonelit,
4. Aprovon në Parim Statutin e Komunës së Kaçanikut, dhe të njëjtin Vendosë të e lëshoj në procedurën e Debatit Publik.

MBLEDHJA e III-të(Tretë)

Mbledhja e tretë është mbajtur më datë: 27.03.2008.

Këtë mbledhje e kryeson dhe e udhëheq z.Xhelal Gashi, Zëvendëskryesues i kuvendit të komunës.

Në këtë mbledhje;

1. E jep Betimin dhe e Nënshkroj Deklaraten Solemne për anëtar të Kuvendit të Komunës, Hajrush Dullovi nga subjekti i PDK, njëkohësisht e deklaroj edhe gjendjen e pasurisë.

2. Formohet Komiteti për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale, në përbërje;

1. Fevzije Bersha, PDK, anëtar,
2. Lejla Koxha, LDK, anëtar,
3. Sevdije Frangu, AAK, anëtar,
4. Sinan Zeneli, apolitik, anëtar dhe
5. Besim Ilazi, apolitik, anëtar.

3. Formohet Komiteti për Arsim dhe Kulturë, në përbërje;

1. Danush Koxha, PDK, anëtar,
2. Sylejman Neziraj, PDK, anëtar,
3. **Hyrijete Isufi, LDK, anëtar,**
4. Shefki Guri, apolitik, anëtar dhe
5. Fëllënza Shehu, apolitik, anëtar.

4. Formohet Komiteti për Zhvillim Ekonomik, në përbërje;

1. Diana Bajrami, PDK, anëtar,
2. Afrim Loku, AKR, anëtar
3. **Zajrete Muhaxheri, LDD, anëtar,**
4. Isak Vishi, apolitik, anëtar dhe
5. Njazi Zharku, apolitik, anëtar.

5. Formohet Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në përbërje;

1. Hajrush Dullovi, PDK, anëtar,
2. Miqail Vila, AAK, anëtar,
3. Naser Troni, AKR, anëtar
4. Qamil Stagova, apolitik, anëtar dhe
5. Agim Vishi, apolitik, anëtar.

Kryesuesit e këtyre katër komiteteve u vendosë të zgjidhen nga radhet e veta.

Mësohet se kryesues i komitetit për Arsim dhe Kulturë është caktuar- Sylejman Neziraj, për Komitetin për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale- Fevzije Berisha, për Komitetin për Zhvillim Ekonomik -Afrim Loku dhe për Komitetin për Planifikim Urban- Naser Troni.

Përbërja e Komitetit për Arsim dhe Kulturë dhe e Komitetit për Zhvillim Ekonomik pas një periudhe pësojnë ndyshime më atë që anëtarët: Hyrijete Isufi dhe Zajrete Muhaxheri ofërojnë dorëheqje, ndërkaq në vend të tyre nuk caktohet kush.

6. Refuzohet propozim Vendimi i kryetarit të komunës për caktimin e pagesës mujore të stafit politik, i nxjerrë në bazë të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës 08/2008,

7. Aprovohet Vendimi për shërndarjen e Grantit Shtesë të Tatimit në Pronë, për “Asfaltimin e rrugëve në lagjen “Dushkaja”,
8. U njoftua kuvendi i komunës me Raportin Financiar të vitit 2007, të pregaditur sipas Standardeve Europiane,
9. Merr Vendim për Ndërtimin e shkollës 5 klasëshe në lagjen Dushkaja.

Mbledhja e IV-të (Katërt)

Mbledhja e katërt është mbajtur më datë: 30.04.2008, kryesuar dhe udhëhequr nga z.Xhabir Zharku, kryetar komune.

Në këtë mbledhje;

1. Beqir Krasniqi, nga subjekti i PDK-së e bëri Betimin dhe Nënshkroj Deklaratën Solemne për anëtar të kuvendit të komunës dhe e Deklaroj Gjendjen e Pasurisë.
2. Aprovohet Lista e Projekteve për Financim nga donatorët për vitet 2008 dhe 2009,
3. Aprovohet Raporti Bugjetor për periudhën janar-mars 2008,
4. Merr Vendim për emërimin e rrugës së fshatit Runjevë, më emrin e dëshmorit të kombit, Kemajl Thaqi,
5. Merr Vendim për caktimin e Lokacionit për ngritjen e Bustit të dëshmorit të kombit, Ismajl Raka,
6. Merr Vendim për caktimin e Lokacionit për ngritjen e Bustit të veprimtarit të çështjes kombëtare-ish kryetarit të kuvendit të komunës, Sali Bajra,
7. Merr Vendim për emërimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kaçanik, më emrin “DËSHMORET E LIRISË” (emërtimi përfshinë dëshmoret e UÇK-së: Jehona Raka, Lumnije Raka, Emsale Frangu dhe Mukadeze Lika-Muhaxheri).
8. Merr Vendim për ndërrimin e destinimit të dy ngastrave Kadastrale në fsh. Qafëshqipe (Gllloboçicë).

MBLEDHJA e V-të (Pestë)

Mbledhja e pestë është mbajtur më datë: 30.05.2008, është kryesuar dhe udhëhequr nga z.Xhelal Gashi, Zëvendëskryesues i kuvendit të komunës.

Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës,

1. Aprovon Raportet e Punës së Drejtorive Komunale për vitin 2007,
2. Aprovon Statutin e Komunës së Kaçanikut,
3. Merr Vendim për Lejimin e mjeteve shtesë për realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugës në fsh. Stagovë”.

MBLEDHJA e VI-të (Gjashtë)

Mbledhja e gjashtë është mbajtur më datë: 15.07.2008, kryesuar dhe udhëhequr nga z. Xhabir Zharku, kryetar komune.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës merr;

1.Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës, në bazë të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

Ndryshimet Statutore do të i bëjë komisioni që e ka hartuar Statutin e Komunës , i cili komision njëkohësisht do të punoj edhe në Hartimin e Rregullorën së Punës së kuvendit,

2.Vendimin për Ridestinimin e mjeteve të zotuara për Qatinë e QKMF-së , për Blerjen e një Autoambulace

3.Aprovon Raportin për realizimin e mjeteve bugetore për periudhën: janar-qershor 2008,

4 Vendimin për Rishikimin Gjashtëmuorë të Bugjetit të Komunës për vitin 2008,

5. Vendimin për Vërtetimin e Interesit të Përgjithshëm Publik shoqëror për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës “Skenderbeu” në Kaçanik.

MBLEDHJA e VII-të(Shtatë)

Mbledhja e shtatë e Rregullt është mbajtur më datë: 29.08.2008, kryesuar dhe udhëhequr nga z. Xhabir Zharku, kryetar komune.

Në këtë mbledhje, kuvendi i komunës;

1.Merr Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit,

2.Caktohet dy kandidatë për të garuar për të u zgjedhur për kryesues Kuvendi dhe ate: Xhelal Gashi nga PDK-a dhe Lejla Koxha nga LDK-a.

3.Merr Vendim për zgjedhjen e z. Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit të komunës,

4.Aprovon në parim Statutin e Komunës së Kaçanikut, i hartuar sipas LVL, dhe të njëjtin vendosë të e leshoj në procedurë të Debatit Publik më qytetarë.

5. Merr Vendim për rritjen e Bugjetit të Komunës për vitin 2008, nga të hyrat vetjake komunale dhe shpërndarjen e tyre për shpënzime.

6. Aprovon Kornizën Afatmesme Bugjetore të Komunës së Kaçanikut për vitet 2009-2011.

7. Debaton për Raportin e komisionit për shqyrtimin e planifikimit të rrejtit shkollor fillor për vitin shkollor 2008/2009.

MBLEDHJA E VIII-të (Tetë)

Mbledhja e VIII-të e Rregullt është mbajtur më datë: 25.09.2008, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendi.

Në këtë mbledhje;

1. E bënë Betimin dhe e Nënshkruan Deklaratën Solemne dy anëtarë të kuvendit të komunës dhe ate: Shefqet Lusnjani nga PDK-a dhe Elife Murseli nga LDD-a, njëkohësisht e deklaruan edhe gjendjen e pasurisë.

2. Aprovohet Statuti i Komunës së Kaçanikut, i nxjerrë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale,

3. Aprovohet Rregullorja për vendosjen e Tatimit në Pronë në teritorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2009,

4. Aprovohet Propozimi për shtimin e tarifave dhe ngarkesave në DUKMM, sipas Udhëzimit Administrativ, 06/2008 të MSHP.

5. Aprovohen 3 kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ate ndërtimore,

a) Kërkesa e Rufki Kuka /lënda: 01Nr.5088/08,

b) Kërkesa e Nehat Avdi Dalloshit/lënda: 01Nr.5505/08 dhe

c) Kërkesa e Avni Kuqit /lënda: 01Nr.4998/08.

Më konkludim që dy kërkesat e para për të cilat toka është e klasit 2 dhe 3, më u pajisur më: Pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë ,konform Rregullativës Ligjore.

6. Merr Vendim për kompenzimin e Stafit Politik .

Mbledhja e IX-të(Nëntë)

Mbledhja e nëntë është mbajtur më datë: 13.11.2008, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues kuvendit të komunës.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Raportin për Realizimin e mjeteve bugjetore për periudhën: janar-shtator 2008,

2. Merr Vendim për dhënjën e Pëlqimit për shpalljen e Zonave Industriale,

3. Aprovon Rregullorën e Punës së Kuvendit të Komunës, dhe

4. Aprovon Marrëveshjen për krijimin e Zonës Ekonomike të Lindjes.

Mbledhja e X-të(Dhjetë)

Mbledhja e X-të është mbajtur më datë: 23.12.2008, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues Kuvendi.

Në këtë Mbledhje;

1. E dhanë dhe e nënshkruan Betimin solemn dhe e deklaruan gjendjen e pasurisë anëtarët e zgjedhur të kuvendit të komunës nga subjekti i LDK-së, Teuta Hoxha dhe Kadrush Dogani,

2. U aprovua Raporti Final i Komunës së Kaçanikut për vitin 2009,

3. U Aprovua Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit për vitet 2009-2011,
4. U debatua : Çeshtja e Informimit-Kontrata me Radio Kaçanikun dhe Kontrata për Mbajtjen e Web Faqes Zyrtare.
5. Kuvendi i Komunës Kaçanik gjat vitit 2008 ka mbajtur 2 mbledhje më karakter Solemn dhe ate: njëra është mbajtur më datë: 17.02.2008 për nderë të **“Ditës së PAVARËSISË SË KOSOVËS”**, ndërsa mbledhja tjetër është mbajtur më datë: 11 Qershor 2008 për Nderë të **Ditës së Çlirimit të Komunës**. janë organizuar dy debate publike me qytetarë të komunës, njëra nga to nuk është mbajtur në mungesë të publikut.

Fjalë përmbyllëse e Kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, mbajtur në Mbledhjen e fundit, përmbyllëse (të X) të Kuvendit të Komunës, 23 dhjetor 2008

I nderuar z. Kryesues, të nderuar përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, Qeverisë së Kosovës, media, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal dhe ju qytetarë shumë të respektuar,

Që nga dhjetori i viti 2007 kam filluar të ushtroj detyrën e kryetarit të komunës së Kaçanikut. Si hap të parë kam ndërmarr masat për të vendos një disiplinë dhe rregull, si në respektimin e orarit të punës, përdorimin e mjeteve të punës në mënyre të drejtë dhe të kontrolluar, por edhe shtimin e efikasitet në punë. Me një organizim të ri jemi përpjekur që të vendosim rend dhe rregull në rrugët e qytetit sidomos në largimin nga rruga të shitësve duke i vendosur në tregu i gjelbër, gjithashtu tregun e kafshëve e kemi postuar afër tregut të gjelbër, por prapë mendojmë që kemi mjaft punë për të bërë në këtë drejtim.

Jemi përpjekur dhe deri diku ia kemi arritur që të krijojmë hapësira të reja në qytet duke kërkuar heqjen e qoshqeve dhe shitoreve të cilat kanë pasur leje të përkohshme por që nuk kanë kryer obligimet dhe i kanë zënë frymën lagjeve të caktuara por edhe qytetit në përgjithësi.

Besoj se në këto raste, jemi kuptuar drejt nga pjesa me e madhe, prandaj objektet janë larguar nga vet qytetarët por ende ka punë për tu bërë në këtë rrafsh pasi që deri më tani fatkeqësisht nuk kemi pasur Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin Zhvillimor Urbanistik të qytetit, kurse tani është në përpunim e sipër dhe shpresojmë që me një angazhim të përbashkët e ardhmja jonë dhe qytetarëve tanë do të jetë me e mirë. Bazuar në zhvillimin dhe situatat e reja të ekonomisë së tregut ne nuk guxojmë të lejojmë që të bëhen investime të përkohshme apo formale por duhet ti inkurajojmë qytetarët tanë dhe afaristët që të bëjnë investime afatgjate dhe të qëndrueshme, prandaj në shërbim të kësaj iniciative kam kërkuar pëlqimin tuaj dhe ju falënderoj për miratimin që keni bërë në mbështetjen e identifikimit dhe shpalljen e zonave industriale e komerciale si nxitje për investime dhe zhvillim.

Në shërbim të kësaj iniciative për të nxitur investime në komunën tonë unë personalisht, si dhe z. Haset Loku dhe z. Fikri Verbani kemi pasur një vizitë në Turqi, në vilajetin e Kajzerit dhe me këtë rast jemi munduar të nxisim prodhuesit e këtij vendi industrial që të investojnë në vendin tonë, duke hapur reparte të ndryshme në fushën e prodhimit.

Më 9 gusht, një delegacion nga komuna Mimar Sinan ka vizituar komunën tonë për tu njoftuar me mundësit reale që ekzistojnë për investime në fusha të caktuara.

Në interes të këtij bashkëpunimi kemi pasur një takim në zyrën e ministrit, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, z.Lutfi Zharku, i cili njoftoi miqtë nga Turqia për mundësit e mira për investime që ofrojnë komunat e Kosovës në përkrahje të fuqishme nga qeveria e Republikës së Kosovës, prandaj shfrytëzoj nga rasti që të kërkoj nga ju dhe qytetarët në përgjithësi që të kenë një angazhim shtesë në nxitje të investimeve sepse vetëm iniciativat private janë ato që zhvillojnë vendin në këto rrethana të ekonomisë së tregut, kurse ne si pushtet kemi për obligim t'ju krijojmë kushte dhe lehtësira ligjore .

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe qytetarë të komunës, Viti 2008 ishte viti më i suksesshëm në shumë drejtime, sidomos 17 shkurti, Dita e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, dita për të cilën shumë breza e gjenerata të tëra sakrifikuan jetën e tyre deri në vet flijim, por në fund, një shkëndijë e shpresës dhe buzëqeshjes u lajmërua në horizont edhe pse ajo ditë e ftohtë dhe plotë acar, por sigurisht një ditë për një të ardhme me të mirë për ne dhe brezat e ardhshëm.

Kaçaniku si gjithmonë i përgatitur, populli, rinia, luftëtarët e UÇK-së, të gjithë strukturat politike dhe organizatat e dala nga lufta, të gjithë të bashkuar në një Këshillë Organizativ, priten ditën e pavarësisë duke dhënë mesazhin për të gjithë se Kaçaniku është i bashkuar kur është interesi i përgjithshëm. Në veçanti, Gryka e Kaçanikut ishte mikpritëse për të gjithë, me flamuj kombëtarë për të cilin është derdhur gjak, po në këtë grykë në të gjitha periudhat historike flamuri i madh në shkëmb të grykës së Kaçanikut ishte dhe është simbol për të gjithë brezat dhe periudhat historike, dhe 101 flamujt që simbolizonin dëshmorët e kombit të UÇK-së të cilët bënë roje në dy krahët e urës. Flamuj besnik për shtet dhe pavarësi.

Viti 2008, ishte vit i suksesshëm për komunën tonë, edhe në fusha tjera.

Komuna jonë sivjet është dalluar për nga përmbushja dhe tejkalimi i obligimeve ndaj shtetit, si tatimin në pronë e që si shpërblim kemi përfituar 160.000 €, gjithashtu kemi përmbushur të gjitha obligimet ligjore siç janë: Miratimi i Statutit të Komunës, Rregullorja e Punës Kuvendit dhe Rregullorja e Tatimit në Pronë, pastaj formimin e Komiteteve dhe Komisioneve që janë obligim ligjor e që ne i kemi përmbushur para afatit të caktuar.

Administrata jonë ka pasur një përkushtim të jashtëzakonshëm në shërbim të qytetarëve në rregullimin e dokumentacionit, pasi që ka qenë vit i ndryshimeve të shumë dokumenteve, sidomos duke punuar me orar të zgjatur në kohë të pushimeve, për ti ardhur në ndihmë qytetarëve në veçanti atyre nga emigracioni.

Në rrafshin e arsimit, sportit dhe kulturës po ashtu kemi ndryshime pozitive sidomos në shpalljen e konkurseve në dy raste në përpjekje për të gjetur kuadro më të mirë.

Në sport dhe kulturë po ashtu ka përmasime dhe shtim të aktiviteteve të cilat do ti keni të prezantuara në raportin e drejtorisë por këtu vlen të veçohet manifestimi i 17 shkurtit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe koncertin për mërgimtarët tanë. Kemi përmirësime edhe në infrastrukturën e objekteve shkollore por nuk jemi të kënaqur pasi që nevojat janë më të mëdha, ndërkohë që kemi premtime dhe besojmë se viti 2009 do të jetë shumë më i mirë.

Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit në krye me z.Limaj ka qenë fuqishëm përkrahë neve, prandaj mund të themi se jemi të kënaqur në krahasim me 8 vitet e fundit. Gjithashtu, jemi të përgatitur me projekte që në vitin 2009 të përfitojmë edhe më shumë projekte dhe për këtë besojmë se do të kemi suksese por kërkojmë nga ju këshilltarë të nderuar që të ndikoni pozitivisht tek komunitetet nga vini që të bëjnë projekte konkrete ngase pa to ne jemi të hendikepuar që t'ju vijmë në ndihmë.

Kërkojmë që qytetarët tanë të jenë në nivel të kryerjes së obligimeve ndaj shtetit si: tatimin në pronë, energjinë elektrike, shërbimet e ujit dhe mbeturinave ngase ne kur kërkojmë investime, nuk duhet të kemi obligime. Në veçanti për investimet në përmirësimin e rrjetit energjetik, sepse nëse kemi borxhe ndaj KEK-ut, mbesim në pozita të palakueshme. Gjithashtu ndodh kur kërkojmë shërbim me ujë dhe nivel të pastërtisë së qytetit. Në ekonominë e tregut nuk ka shërbime falas andaj ne së bashku e kemi për detyrë që të ndikojmë tek qytetarët, sepse sa më shpejt që ta kuptohet kjo çështje, niveli i jetesës dhe shërbimi do të jetë më i mirë

Mendoj se edhe për konferencë të donatorëve kemi qenë mjaft të përgatitur por disa çështje nuk varen nga ne, ndërsa neve nga mbetet që gjithnjë të jemi në nivel dhe gjendje gatishmërie. Po ashtu grupet tona kanë marr pjesë edhe ne grupet e ekspertëve për hartimin e Strategjisë Zhvillimore për Turizëm dhe Strategjisë Lokale për Zhvillim Rural.

Në këtë vit kemi pasur ngecje në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë pasi që sipas udhëzimeve administrative të ristrukturimit të pushtetit lokal, kjo drejtori pushoi së vepruari, por me Statutin Komunal e kemi paraparë duke i parë nevojat e mëdha për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë dhe degët e tyre përcjellëse

Në shëndetësi gjendja është shumë më e mirë se në të kaluarën por kemi ende pengesa sidomos me barërat esenciale të cilat nuk varen nga ne. Një pjesë e objektit dhe kulmi janë rinovuar. Po ashtu me ndihmën e Ministrisë së Pushtetit Lokal kemi blerë një autoambulancë të re e cila do të jetë në shërbim të QKMF-së, ndërkohë që jemi të kënaqur me kuadrin profesional të angazhuar kohëve të fundit.

Në shërbim të kontakteve dhe transparencës me qytetarët tanë organet tona kanë bërë hapa konkret në këtë drejtim sidomos me rregullimin e dyerve të zyrave me xhama të tejdukshëm, që qytetarët të shohin punën e administratës drejtpërdrejt. Hapja e Web faqes Zyrtare të komunës në internet dhe kontrata me Radio Kaçanikun janë bërë me qëllim që qytetari ynë të jetë i informuar, të përcjell aktivitetet dhe vendimet e organeve komunale, kjo është një punë apo thënë me drejt një përpjekje në shërbim transparencës. Në këtë drejtim ka ende vend për t'u përmirësuar por gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe rrethanat ekzistuese e jo me paragjykime apo tendenca që dikush mund të ketë në këtë fushë. Edhe njëherë e përsërisë se informimi sado i mirë që të jetë asnjëherë nuk është i përkryer dhe i mjaftueshëm.

Të nderuar qytetarë, anëtarë të Kuvendit Komunal.

Jam munduar që në vija të trasha të ju njoftoj mbi të arriturat e punës sonë për gjatë vitit 2008.

Për detajet do të njoftoheni në raportet e punës së secilës drejtori, në mesin e Janarit 2009, dhe sigurisht që, në të njëjtën mbledhje do të njoftoheni me programin e punës për vitin 2009.

Më këtë rast dua t'ju njoftoj se qeveria komunale edhe në vitin 2008 ka pasur një program pune dhe në saje të atij programi janë kryer të gjitha këto punë dhe nuk është aspak e vërtet se qeveria që unë udhëheq, ka punuar sot për nesër apo sipas rastit ditor siç ka dashtë ta paraqes një koleg yni në debatin e fundit publik. Me këtë rast nuk ju kam njoftuar për ndihmat që kemi ndarë për skamnorët, personat me aftësi të kufizuara, invalidët e luftës dhe veteranët e UÇK-së, pasi që edhe për këto, do të jeni te njoftuar në raport.

Për fund, dua t'ju njoftoj se me gjithë sukseset që kemi arritur në këtë vit nuk duam të krijojmë vetëkënaqësi por dëshiroj që këto suksese të na mobilizojnë për punën edhe më të madhe në shërbim të qytetarëve dhe komunës, sepse fjalët i merr era kurse puna dhe veprat jetojnë përjetësisht. Prandaj, zotohemi, dhe kërkojmë mbështetjen tuaj në punën tonë për vitin 2009, ngase suksesi është i përbashkët edhe atëherë kur keni qenë kritik dhe keni dhënë vërejtje konstruktive.

Shfrytëzoj rastin që juve, familjeve tuaja, qytetarëve të Kaçanikut, e në veçanti familjeve të dëshmorëve, familjeve të viktimave të luftës, invalidëve të luftës së UÇK-së dhe gjithë luftëtarëve të lirisë, t'ju uroj, gëzuar për shumë vjet festën e fundviti me dëshirë që viti 2009 të jetë vit i sukseseve më të mëdha.

Faleminderit z Kryesues, Faleminderit te gjithëve.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut
z.Xhabir Zharku

Viti, 2009

Mbledhja e I-rë (Parë)

Mbledhja e parë është mbajtur më datë: 30.01.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për Planifikimin e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, për vitin 2009,
2. Aprovimi i Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2008,
3. Aprovimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2008,
4. Aprovimi i Programit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2009,
5. Vendimi për bartjen(delegimin) e kompetencës për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në ate ndërtimore, Komitetit për Politikë dhe Financa,

6. Vendimit për mbështetje të Vendimit të Kryetarit të Komunës për Lejimin e Lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit kolektiv me lokale afariste.

Mbledhja e II-të (Dytë)

Mbledhja e dytë është mbajtur më datë: 27.02.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

- 1.Vendimi për Rritjen e Bugjetit të vitit 2008 nga të Hyrat Vetjake Komunale dhe Shpërndarja e tyre për Shpënzime,
- 2.Vendimi për Bartjen e Bilanceve të pashpënzura nga të Hyrat Vetjake Komunale të vitit 2007 dhe 2008 në vitin vijues 2009,
- 3.Aprovimi i Planit për Zbatimin e Rekomandimeve sipas Raportit të Auditimit,
- 4.Vendimi për Shkëputjen e Njesisë Komunale për Mirëmbajtje të Ujit dhe Kanalizimit nga Ndërmarrja Publike KRUK “ Bifurkacioni” të Ferizajt
- 5.Vendimi për Prolongimin e Propozim Vendimit për Caktimin e Vijës Ndërtimore në Rrugët : Bob Doganaj dhe Fushë Pajtimi-Begracë.

Mbledhja e III-të (Tretë)

Mbledhja e tretë është mbajtur më datë: 03.04.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto: Vendime:

- 1.Aprovimi i Raportit Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008(sipas Udhëzimit Administrativ 2008/13),
- 2.Vendimi për shpalljen e Zonave Industriale dhe
- 3.Vendimi për Caktimin e Vijës Ndërtimore në Rrugët: Bob – Doganaj dhe Fushë Pajtimi –Begracë.

Mbledhja e IV-të (Katërt)

Mbledhja e katërt është mbajtur më datë: 27.04.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për Lejimin e mjeteve financiare për kompenzimin e ushqimit të punëtorëve të shendetësisë, dhe
2. Vendimi për Arovimin e Raportit për realizimin e mjeteve bugetore për periudhën: janar-mars, 2009.

Mbledhja e V-të (Pestë)

Mbledhja e pestë është mbajtur më datë: 29.05.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, është marrë :

- 1.Vendim për Rishikimin Gjashtëmujorë i Bugjetit të Komunës për vitin 2009,

Mbledhja e VI-të (Gjashtë)

Mbledhja e gjashtë është mbajtur më datë: 19.06.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë shqyrtuar këto çështje:

1.Kërkesa e MAPL, për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës për Shkëputjen e Njësisë Komunale të Ujit dhe Mbeturinave nga Ndërmarrja Publike KRUK”Bifurkacioni” i Ferizajt.

Vërtetohet Vendimi i marrë nga ana e kuvendit të komunës Kaçanik, si i ligjshëm.

2.Debatim lidhur më shkresën e MAPL për çështjen e Vendimit për Lejimin e Lokacionit për Ndërtimin e Objektivit Kolektiv të banimit me lokale afariste.

Kuvendi i komunës Kaçanik, lidhur më këtë çështje konkludoj se komuna ka fakte të vërtetuara nga DUKMM se prona është e komunës.

Mbledhja e VII-të (Shtatë)

Mbledhja e shtatë është mbajtur më datë: 28.07.2009, kryesuar nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

- 1.U Aprovua Korniza afatmesme bugetore e komunës së Kaçanikut për vitet : 2010-2012,
- 2.U Aprovua Raporti i realizimit të mjeteve bugetore , për periudhën: janar-qershor 2009 dhe Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009,
- 3.U muar Vendim për rritjen e buxhetit të vitit 2009 nga të hyrat vetjake komunale dhe shpërndarja e tyre për shpënzime dhe
- 4.U muar Vendim për themelimin e Vendgjetive të Përbashkëta në komunën e Kaçanikut.

Mbledhja e VIII-të (Tetë)

Mbledhja e tetë është mbajtur më datë: 30.09.2009, kryesuar dhe udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime;

- 1.Vendimi për Aprovimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2010 dhe vlerësimet për vitet 2011-2012,
- 2.Vendimi për Aprovimin e Rregullorës për vendosjen e tatimit në pronë në teritorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2010,
- 3.Vendimi për realizimin e të ardhurave mujore shtesë dhe
- 4.Vendimi për rrëgullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore.

MBLEDHJE TJERA

Kuvendi i Komunës Kaçanik, ka organizuar dhe mbajtur edhe mbledhje më karakter tjetër.

Më datë: 17 shkurt, 2009, është mbajtur mbledhje Solemne në shënimin e Përvjetorit të **Ditës së PAVARËSISË SË KOSOVËS,**

Më 11.Qershor, 2009, është mbajtur mbledhje Solemne për nderë të **Ditës së Çlirimit të Komunës së Kaçanikut**(10 vjetori i Çlirimit nga forcat serbosllave).

Më datë: 19.10.2009, kuvendi i komunës mban mbledhje solemne në shenjë përshendetje dhe falendërimi anëtarëve të këtij kuvendi për aktivitetin 2 vjeçar të punës në kuvend.

Janë organizuar dy debate publike më qytetarë të komunës, nga ana e kryetarit të komunës, njëri tubim nuk është mbajtur në mungesë të publikut.

Më rastin e vdekjes tragjike të drejtorit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj “ Avdullah Malsiu dhe kusheririt të tij Sakip Malsiu në një aksident komunikacioni në fsh. Doganaj të Kaçanikut të datës 29.03.2009, më datën 30.03.2009 nga ora 11:00, kuvendi i komunës ka mbajtur mbledhje Komemorative në shenjë përkujtimi të jetës dhe veprës së të ndjerëve, ndërkaq mbledhja e rregullt e caktuar për këtë datë është shtyrë për datën: 03.04.2009.

Zgjedhjet lokale të vitit 2009, do të mbahen më datë: 15.11.2009,
Fushata zgjedhore ka filluar nga data : 15.10.2009.

Pregaditi: Shërbimi i Kuvendit